

Data 30.04.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

‘Blerje qelqurina,

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Qelqurina 33790000-4

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit: **4 028 936 (kater milion e njezet e tete mije e nenteqind e tridhjetë e gjashtë)**
Lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,te ndryshuar autoriteti/enti kontraktor *Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor ” Tirane,* ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi:Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se: *1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*

2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojces 2;

Argumentimi:*Kjo shtojce eshte pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituara.*

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi:Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ne te cilen eshte e percaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për*

pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se: *Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1Kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese çertifikatën **ISO 9001:2015** mbi “*Sistemet e menaxhimit të cilësisë*” ose **ekuivalente të vlefshme**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetiti akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.
- b) Operatori ekonomik ofertues ne rastet **kur nuk eshte prodhues** i artikujve objekt prokurimi, **duhet te paraqese autodeklarate** qe furnizuesi nga i cili siguron artikujt objekt prokurimi **eshte i certifikuar konformstandarteve te cilesise ISO 9001:2015** mbi “*Sistemet e menaxhimit të cilësisë*”, ose **ekuivalente të vlefshme**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetiti akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

AK rezervon te drejten per verifikimin e vetedeklarimit ne procesin e vleresimit te dokumentacionit dhe ne rastin kur OE ofertues shpallet fitues, duhet te paraqese certifikaten ne fjale.

- c) Kërkohet **Autodeklaratë (Deklarate Konformiteti CE/DC) për mallrat (qelqurinat)**, nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat **MDD 93/42/EC**, ose **98/79 EC**, ose **2015/1535/EU**, kur eshte e aplikueshme, sipas **Direktivave dhe klasifikimit te Keshillit te Europes**, bashkëlidhur me kopjet te certifikatave perkatese **CE/DC (Deklarate konformiteti)**, origjinale, ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara, te vlefshme ne momentin e hapjes dhe dorezimit te ofertave.

Argumentimi: Këto kritere të percaktuar ne piken a) b) dhe c) janë vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, ne te cilen gjejme te percaktuar se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet,*

objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise". Keto kritere jane vendosur qe AK te sigurohet qe malli qe do te ofrohet nga OE te cilet plotesojne standartet nderkombetare dhe kërkesat e cilesise qe kane lidhje me produktet objekt i kesaj procedure.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a. Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2021, 2022 dhe 2023) ku vlera e tyre te jete jo më e vogël se **40% e vlerës së fondit limit.**

*Shënim**: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 40% do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar në Seksionin: 2.10 Përshkrim i shkurtër i kontratës/Marrëveshjes Kuadër, pika 1

**Shënim*: Nëse operatorët ekonomikë, për procedurën e prokurimit që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020, "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...], ne piken 1, piken 2/b dhe piken 3 te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ku percaktohet se: Pika 1: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/b: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Pika 3 "Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në ne piken 1 dhe piken 2/b te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohe në Procedurën e Hapur, ku percaktohet; Pika2/b: ...2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Duke qene se kjo procedure prokurimi bazuar ne vleren e fondit limitndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. AK është qendër ku behen analiza labratorike per rrethin e tiranes, për këtë arsye praktika e vendosur ndër vite e cila ka rezultuar e suksesshme, është ajo e marzheve maksimale të përcaktuara nga legjislatori në Rregullat e Prokurimit Publik si dhe në Legjislacionin e Prokurimit Publik në tërësi. AK ka parashikuar vlerën prej 40 % në mënyrë që të nxisë pjesëmarrjen e sa më shumë OE-ve të cilat kanë eksperiencën e nevojshme dhe stabilitetin e nevojshëm për të kryer me sukses kontratën në rastin e shpalljes fitues, duke qenë se objekti i kontratës është specifik.*

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohe, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

2.3 Kapaciteti teknik:

- a. Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.
 - Si dëshmi për përvojën e mëparshme me nje ent publik, kërkohe **vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratën ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar**

sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.**

Shënim:*Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar në Seksionin: 2.10 Përshkrim i shkurtër i kontratës/Marrëveshjes Kuadër, pika 1.

*Argumentimi:*Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik" ,ne te cilin gjejme te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

- a. **Për të gjithë artikujt e kërkuar** sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (Specifikimet teknike), **te paraqitet Katalogje, ku te përfshihen specifikimet teknike te hollësishme për artikullin e kërkuar**(pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe

*specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohet, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te **markuara sipas artikullit**) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.*

Argumentimi. Ky kriter është vendosur nga anëtari i NJP që ka specialitet përkatës në lidhje me kriteret teknike si dhe është në përputhje me nenin 4 pika 38/b, nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik, si dhe me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se:[...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: [...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].*

Paraqitja e katalogeve për të gjithë artikujt që janë objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përuethshmërisë së materialeve/artikujve objekt i procedurës së prokurimit që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të përcaktuara në DST në Shtojcën 5, me qëllim sigurimin e produkteve /materialeve/artikujve të kërkuara të kësaj procedure prokurimi

- a. Operatori ekonomik duhet te paraqese **oferten teknike**, per artikujt e kerkuar ne forme tabele, ku te plotesohet: **Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit**, Skadencia e mallit ne ato artikuj ku aplikohet, Emertimi i katalogut te artikullit/produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet perkatese per produktet.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur nga anetari i Njesise se Prokurimit qe ka specialitet perkatese ne lidhje me kriteret teknike, me qëllim që të identifikohet përmbushja e specifikimeve teknike për artikujt e kërkuar si dhe eshte ne perputhje me **piken 1 te nenit 36 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”**, ne te cilen eshte e percaktuar se: *1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. Gjithashtu ky kriter eshte ne perputhje me piken 2 te nenit 40 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të**

rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Në këtë kontekst është kërkuar dhe oferta teknike, me anë të së cilës do të bëhet e mundur verifikimi me i saktë i artikujve të ofertuar, specifikimeve të tyre, origjina, konformiteti etj me dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga ofertuesi.

b. **Për artikujt e shënuar me Asterisko (*), duhet të paraqiten mostra** ditën e hapjes se ofertave, me date 13.05.2024 ne oren 10:00. Dorëzimi i kampioneve/ mostrave, të bëhet prane Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse pranë NJVKSH Tiranë, te mbyllura ne nje zarf /kuti jo transparente te vulosur mbi te cilin te shenohet:

- “Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave te procedurës se prokurimit « » dhe jo para dates 13.05.2024, ora 10.00.
- Se bashku me mostrat ofertuesi duhet te japë edhe një shkresë te vulosur dhe firmosur ku te listohen mostrat qe ndodhen ne zarf/kuti.
- Mbi çdo mostër te dorëzuar, ofertuesi duhet te shënoje Nr.Rendor te Artikullit qe përfaqëson.

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë te shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj te veçantë, atëherë oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te s’kualifikohet.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 40, pika 6, gërma a) ku cilësohet se: Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”**.

QELQURINA

Nr	Emertimi	Specifikime	Njesia
1	Ambalazh njeperdorimsh	Me tiosulfat per marrje mostre te ujit, sterile, 250 ml, material Polipropilen	cope
2*	Ambalazh njeperdorimsh	Me tiosulfat per marrje mostre te ujit, sterile, 500 ml, material Polipropilen	cope
3	Ansa njeperdorimshe	Ansa blu njeperdorimshe 10 µl unaze sterile,Polistiren	cope
4	Balone	I taruar, qelqi, klasi A, zjarrdruues, 500 ml, tolerance ± 0.250 ml	cope
5	Beaker	I shkallezuar, qelqi Borosilikat zjarrdruues, 400 ml	cope
6	Beaker	I shkallezuar, qelqi, zjarrdruues, 500 ml	cope
7*	Beaker	I shkallezuar, qelqi Borosilikat, zjarrdruues, 1000 ml	cope

8*	Kosh (mbajtëse tubash)	inoks, me permasa afersisht 20x20x20 cm	cope
9	Kriotuba	per ruajtjen e materialeve biologjike ne temperatura shume te uleta , 2 ml,sterile	cope
10*	Tampon	Tampona Steril me epruvete PP, me dimensione 12x150 mm (pa terren)	cope
11	Kupshore	Kupshore porcelani Ø 10-11 cm, fundsheshte	cope
12*	Lama	Lama me permasa 26x76 ,jo korrozive, trashesi 1 mm, kuti/50 cope	kuti
13*	Lamela	Lamela me permasa (22x22), kuti/200 cope	kuti
14*	Maja pipete	Maja per mikropipete Ependorf,ose ekuivalent, 10-100 µl	cope
15*	Pipeta	Klas AS me shkallezim me ngjyre blu, qelq Volum 10 ml	cope
16	Pjata petri	qelqi, Ø 90 mm, zjarr duruese, lartesia 2 cm	cope
17*	Pjata petri	Ø 60 njeperdorimshe, polistiren	cope
18*	Pjata petri	Ø 90 njeperdorimshe, polistiren	cope
19*	Pjata petri	Ø 120 njeperdorimshe, polistiren	cope
20	Puar	gome pipetimi universal me tre valvola	cope
21	Tampona	Tampon me pambuk, me bisht druri qese me 100 cope	qese
22	Termoboks	me pllake akulli, 22.5 litra	cope
23*	Tuba	Epruvete per perzierje ,qelq qe ti rezistojte temperaturave te autoklavimit,me gryke zmerile,me tape,e graduar , 50 ml me NS19/26	cope
24*	Tuba Durhan	Ø35x6 mm trashesia e pareteve 0.65 mm	cope
25*	Tuba qelqi	Ø 12x100 mm	cope
26*	Tuba qelqi	Ø 30x200 mm me fund te rrumbullaket	cope

- **Afati i skadencës për qelqurinat: *Data e skadencës në ditën e lëvrimin të mallit, për ato artikuj në të cilën aplikohet skadencia, duhet të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.***
- **Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimi për çdo artikull.**

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

QELQURINA

Artikulli	Pershkrim	Specifikime	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Ambalazh njeperdorimsh	Me tiosulfat per marrje mostre te ujit, sterile, 250 ml, material Polipropilen	7000	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
2*	Ambalazh njeperdorimsh	Me tiosulfat per marrje mostre te ujit, sterile, 500 ml, material Polipropilen	7000	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
3	Ansa njeperdorimshe	Ansa blu njeperdorimshe 10 µl unaze sterile,Polistiren	16500	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
4	Balone	I taruar, qelqi, klasi A, zjarrdurues, 500 ml, tolerance ± 0.250 ml	2	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
5	Beaker	I shkallezuar, qelqi Borosilikat zjarrdurues, 400 ml	2	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
6	Beaker	I shkallezuar, qelqi, zjarrdurues, 500 ml	1	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
7*	Beaker	I shkallezuar, qelqi Borosilikat, zjarrdurues, 1000 ml	2	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
8*	Kosh (mbajtese tubash)	inoks, me permasa afersisht 20x20x20 cm	10	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
9	Kriotuba	per ruajtjen e materialeve biologjike ne temperatura shume te uleta , 2 ml,sterile	1500	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
10*	Tampon	Tampona Steril me epruvete PP, me dimensione 12x150 mm (pa terren)	11000	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
11	Kupshore	Kupshore porcelani Ø 10-11 cm, fundsheshte	1	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
12*	Lama	Lama me permasa 26x76 ,jo korrozive, trashesi 1 mm, kuti/50 cope	115	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
13*	Lamela	Lamela me permasa (22x22), kuti/200 cope	18	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
14*	Maja pipete	Maja per mikropipete Ependorf,ose ekuivalent, 10-100 µl	1000	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

15*	Pipeta	Klas AS me shkallezim me ngjyre blu, qelq Volum 10 ml	200	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
16	Pjata petri	qelqi, Ø 90 mm, zjarr duruese, lartesia 2 cm	50	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
17*	Pjata petri	Ø 60 njeperdorimshe, polistiren	5500	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
18*	Pjata petri	Ø 90 njeperdorimshe, polistiren	15000	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
19*	Pjata petri	Ø 120 njeperdorimshe, polistiren	1500	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
20	Puar	gome pipetimi universal me tre valvola	1	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
21	Tampona	Tampon me pambuk, me bisht druri qese me 100 cope	45	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
22	Termoboks	me pllake akulli, 22.5 litra	1	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
23*	Tuba	Epruvete per perzierje ,qelq qe ti rezistojte temperaturave te autoklavimit,me gryke zmerile,me tape,e graduar , 50 ml me NS19/26	30	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
24*	Tuba Durhan	Ø35x6 mm trashesia e pareteve 0.65 mm	3000	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
25*	Tuba qelqi	Ø 12x100 mm	3500	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
26*	Tuba qelqi	Ø 30x200 mm me fund te rrumbullaket	1500	Pranë magazinës së NJVKSH Tiranë	Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

Afatet e lëvrimit:

Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

Sasia dhe Grafiku i levrimit jane vendosur ne perputhje me **piken 1 te nenit 40 te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021** “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen gjejme te

percaktuar se: *1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.*

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialist te fushës, anëtar të njësisë së prokurimit. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 13.05.2024, ora 10:00.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Qelqurina”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

- **Dokumentat e tenderit.**

NJËSIA E PROKURIMIT